



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndërtesa e "Fakultetit Teknik", 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: [fn@uni-pr.edu](mailto:fn@uni-pr.edu)

Ref. nr. 1716/1 Prishtinë 07.07. 2023

PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

DEPARTAMENTI HIDROTEKNIK

Studenti **Endrit Zeqiraj** ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: " **Modelimi hidraulik i vërshimeve në lumin Istog**" në programin e studimeve Hidroteknik dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

**Abstrakt**

Qëllimi i këtij punimi është analiza e vërshimeve që po ndodhin në komunën e Istogut dhe masat që duhet të ndërmerren më qëllim të zbutjes së dëmeve nga vërshimet.

Njeriu duke e shfrytëzuar tokën përmes ndërtimeve afër lumit, eksploatimit të pa kriter të shtretërve të lumenjve dhe hudhjes së mbeturinave në lumenj, ka ndikuar që të rritet shpeshësia dhe magnituda e vërshimeve, viteve të fundit. Një faktor tjetër me shumë rëndësi është edhe ndryshimi i klimës, viteve të fundit, me ç'rast po paraqiten më shumë thatësi dhe reshje ekstreme si pasojë e ngrohjes globale. Në këtë punim, kam përdorur literaturën për lumenjtë dhe vërshimet që ndodhin nga ta. Kam përshkruar gjendjen hidrogeologjike të komunës së Istogut, historikun e vërshimeve në komunën e Istogut, definicionin për lumenjtë, reshjet, matjet hidrometrike dhe pastaj kam arritur në pjesën e modelimit, ku së pari kam bërë matjet gjeodezike për sipërfaqen vërshuese për segmentin e lumit që e kam trajtuar.

Pastaj duke u bazuar në prurjet maksimale të lumit Istog, kam bërë analizën e prurjeve maksimale shumëvjeçare me metodat e Gumbel-it, Pearson-it, log Pearson-it, metodën normale dhe log normale, ku sipas rezultateve, kam marrë parasysh prurjen maksimale 50 vjeçare me vlerën më të madhe nga këto metoda, përkatësisht nga metoda log normale me vlerë  $Q_{maks} = 84.46 \text{ m}^3/\text{s}$ . Prurjen maksimale 50 vjeçare e kam futur në HEC RAS ku kam bërë modelimin hidraulik të vërshimeve për segmentin e trajtuar dhe sipas rezultateve, është përcaktuar që ana e majtë në kahje me rrjedhjen e ujit, është më e rrezikuar nga përmbytjet si pasojë e numrit më të madh të objekteve të afaristo-banimore.

Duhet pasur parasysh mungesën e të dhënave hidrologjike të prurjes nga instituti hidrometeorologjik i Kosovës. Nga të dhënat historike kam nivelet për vitet 1975-1999, 2007-2011 dhe 2015-2022. Të dhënat nga viti 1999 deri 2007 dhe nga 2011 deri 2015 janë të përvetësuara, duke bërë një ngjajshmëri me nivelet e matura. Në përfundim të këtij punimi, konkludojmë se mbrojtja nga vërshimet për komunën e Istogut, nga vërshimet e lumit Istog është ende e vogël. Kështu që duhet të rregullohet shtrati i lumit i cili i përballon këto prurje, të mos ndërtohen objekte afër shtratit të lumit dhe së bashku me qytetarët të krijohet vetëdija që ta ruajnë pastërtinë e shtratit të lumit duke mos hedhur mbeturina.

Fjalët kyçe: vërshimet, lumi i Istogut, Pellgu i lumit Istogut, prurjet, modelimi hidraulik, matjet hidrometrike.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimitarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimitarisë.